



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT "BARLETI"

DHE

**"SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË" PËR REALIZIMIN E
PROJEKTEVE TË PËRBASHKËTA**

Preambul: Universiteti Barleti (UniBa) dhe Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë në vijim të quajtura Palë:

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të sistemit arsimor dhe promovimit të standardeve më të fundit sigurative në kuadër të modernizimit të sistemit arsimor dhe atij të sigurimeve :

Duke marrë në konsiderate politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra për funksionimin dhe përmirësimin e një sistemi arsimor profesional të përgjegjshëm dhe modern për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimeve sociale, në promovimin e standardeve më të fundit në tregun e sigurimeve me qëllim rritjen e investimeve dhe prezencën në ekonominë shqiptare ;

Duke vlerësuar angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta në veprimtarinë dhe etikën e të gjitha hallkave të sistemit arsimor ;

Duke konsideruar se një ndër objektivat kyçe në ushtrimin e veprimtarisë së sistemit arsimor është efikasiteti dhe eficaenca e administratës arsimore të këtij Universiteti në përputhje me standardet dhe praktikën me të mira vendase dhe ato perëndimore;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të këtij memorandumi për të përmbushur edhe angazhimet në kuadër të Integritimit Evropian të sistemit arsimor në fushën e sigurimeve ;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale: në ligj Nr. 80/2015 " Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, aktin të themelimit si person juridik në datë 29.01.2003 të Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë me anëtarë themelues të saj 5 shoqëri sigurimi: INSIG SHA, SIGMA SHA, SIGAL SHA, ATLANTIK SHA dhe INTERSIG SHA .

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në Vijim Marrëveshje.

Neni 1

Qëllimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve

Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi është krijimi i një bashkëpunimi **Universitetit BARLETI** (në vijim UniBa), Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë dhe Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë, për zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve, shkëmbimin e eksperiencave të përbashkëta , promovimin e punimeve shkencore të shërbimeve financiare novatore për të gjithë llojet e investitorëve, sjelljen e ideve inovatore në shërbim të politikave të zhvillimit për një vendimmarrje të drejtë dhe të mbështetur në punime kërkimore dhe shkencore si dhe për mbështetjen e zhvillimeve të qëndrueshme të ekonomisë duke shfrytëzuar kapacitetet dhe burimet njerëzore ekzistuese duke krijuar ekspertë të aftë për tregun e kësaj fushe.



Neni 2

Objekti i bashkëpunimit ndërmjet palëve

Objekti i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi ka si objekt të saj :

- a. Identifikimin e mekanizmave të nxitjes së punës kërkimore shkencore të Universitetit dhe zbatimit praktik të tyre, nxitjen dhe motivimin për punime shkencore të studentëve dhe kandidatëve për marrjen e titujve akademikë që krijojnë/ kryejnë punime shkencore, kërkimore, akademike e universitare në ndihmë të institucioneve publike e private;
- b. Ofrimin nga ana e Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë, të mbështetjes për punën kërkimore shkencore në tema të lidhura me fushat financiare, të politikës konservatore të investimeve dhe marrëdhënieve profesionale në shërbimet financiare;
- c. Realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore në fusha të ndryshme.
- d. Kryerjen e praktikave dhe të proceseve mësimore të studentëve të Fakultetit të Ekonomisë pranë ambienteve dhe zyrave Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë;
- e. Shkëmbimin e përvojës së dyanshme të palëve në lidhje me menaxhimin insitucional;
- f. Pjesëmarrje të përbashkëta të palëve në konferenca, seminare evenimente dhe takime akademike, realizimin e aktiviteteve dy palëshe si dhe publikimeve të përbashkëta kërkimore shkencore;
- g. Ofrimin e ekspertizës nga ekspertët e Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë në funksion të përsosjes së kurrikulës së kurseve të ofruara nga Fakulteti i Ekonomisë.

Neni 3

Informacion mbi Palët

1. Universiteti "Barleti" është një Institucion i Arsimit të Lartë jo Publik, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkuruar në tregun Ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi i një institucioni akademik elitë, bazuar në praktikën dhe vlerat më të mira ndërkombëtare, me programe shumëdisiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.
2. Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë regjistruar si person juridik me vendimin nr. 560, datë 03.03.2003 është organizatë jo-fitimprurëse e cila përpiqet të promovojë standartet më të fundit sigurative të anëtarëve të saj për zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e industrisë shqiptare të sigurimeve. Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë (SH S SH) është organi përfaqësues i tregut të sigurimeve në marrëdhëniet me të tretë, brenda dhe jashtë Shqipërisë .

Neni 4

Fusha e veprimtarisë së bashkëpunimit

Kjo marrëveshje bashkëpunimi sipas objektit të saj i shtrin efektet për autoritetet, personelin përkatës dhe studentët e Fakultetit të Ekonomisë si dhe për strukturat dhe autoritetet përkatëse të Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë.



Neni 5

Mënyrat e bashkëpunimit

1. Me qëllim përmbushjen e objektivave të marrëveshjes së bashkëpunimit, secila palë do të caktojë një person si bashkëkoordinues për komunikimin midis tyre dhe përcjelljen e problematikave sipas rastit.
2. Palët do të angazhohen për ngritjen e një grupi të përbashkët pune me qëllim përpunimin, zbatimin e plan veprimi vjetor të përbashkët.
3. Palët bien dakord se do të organizohen për të vënë në dispozicion të publikut të gjerë, informacionin dhe rezultatet e çdo veprimi të përbashkët, përmes medias së shkruar dhe asaj vizive të organizojnë takime periodike, të paktën 1 (një) herë në vit.
4. Palët bien dakord për të shkëmbyer rregullisht informacion dhe përvojë në lidhje me aktivitetet dhe projekte me interes të përbashkët.

Neni 6

Buxheti

Mjetet financiare për zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të mbulohen nga buxhetet përkatëse të secilit institucion, palë të marrëveshjes. Për aktivitetet/projekte të përbashkëta do të hartohen marrëveshje specifike të cilat do i shtohen kësaj marrëveshje si ankese, ku do të jetë e përcaktuar qartë mënyra e zhvillimit të aktiviteteve, detyrat, përgjegjësitë si edhe detyrimet financiare të secilës palë.

Neni 7

Shtesat dhe ndryshimet në marrëveshje

Të gjitha shtesat dhe ndryshimet e kësaj marrëveshjeje marrin vlerë që nga momenti kur ato janë nënshkruar nga të dyja palët. Shtesat dhe ndryshimet që i bëhen kësaj marrëveshje paraqiten në formën e shtojcave që ndjekin rendin alfabetik dhe bëhen pjesë e pandarë e marrëveshjes.

Neni 8

Kohëzgjatja e Marrëveshjes dhe Vlefshmëria e saj

- a. Marrëveshja do të bëhet aktive në ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe do të funksionojë pa afat të përcaktuar .
- b. Nëse secili nga partnerët dëshiron të anulojë Marrëveshjen, ata duhet të njoftojnë 3 (tre) muaj përpara afatit dhe akti i anulimit do të jetë pa paragjykim ndaj veprimeve dhe aktiviteteve ekzistuese dhe në vazhdim.
- c. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të të dy institucioneve.
- d. Kjo Marrëveshje është përgatitur në gjuhën shqipe në 2 (dy) kopje origjinale dhe secila palë do të mbajë 1 (një) kopje origjinale.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët kanë detyrimin të sillen me korrektësi kundrejt njëra-tjetrës. Kjo nënkupton përveç të tjerave që palët gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre të mos cënojnë interesat e njëra-tjetrës.



2. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë marrëveshje në mënyrë të përsëritur nga njëra prej palëve, palës tjetër i lind e drejta që me një njoftim me shkrim 3 muaj përpara të zgjidhë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme. Në çdo rast detyrimet ndërmjet palëve që lidhen me kohën kur marrëveshja ishte në fuqi do të shlyhen.
3. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim dhe palët angazhohen të negociojnë për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme.

Neni 9

Komunikimi mes palëve

1. Palët, angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të meren rast pas rasti.

Neni 10

Konfidencialiteti

Asnjëra nga palët nuk do t'i përdorë dhe nuk do t'ju tregojë të tretëve informacionet konfidenciale të palës tjetër, apo informacionet e përbashkëta sipas dispozitave ligjore të përcaktuara. Të dy palët do të zbatojnë masat e sigurisë në mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e informacionit për të mbrojtur nga qasja e paautorizuar, ndryshimi, zbulimi ose shkatërrimi i të dhënave personale.

Neni 12

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e institucioneve .
2. Kjo marrëveshje përmban 4 (katër) fletë dhe hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale me të njëjtën vlerë, ndër të cilat 2 (dy) kopje i mban Universiteti "Barleti" dhe 2 (dy) kopje Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë.

Nënshkruar në Tiranë, në 12.06 .2023.

UNIVERSITETI "BARLETI"

SHOQATA E SIGURUESVE TË SHQIPËRISË

REKTORI

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

PROF. DR. SUZANA GUXHOLLI

ZNJ. MIMOZA HAJDARMATAJ

